REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 maj 2018
Nr. ref.: RK 1241/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI84/17

Parashtrues

Bahri Maxhuni

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 02/81, të 23 marsit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bahri Maxhuni, nga fshati Maxhunaj, komuna e Vushtrrisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin nr. 02/81 të 23 marsit 2016 të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria e Kosovës), në kuadër të të cilit është miratuar edhe Koncept-dokumenti për rregullimin e skemës pensionale në Republikën e Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të referuar më lart, përmes të cilit, ndër të tjera, është aprovuar edhe Koncept-dokumenti, me të cilin rregullohet skema pensionale në Republikën e Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 korrik 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 1 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar për regjistrimin e kërkesës dhe i ishte kërkuar që ta plotësojë dhe ta qartësojë kërkesën e tij në pajtim me rregullin 29 të Rregullores së punës.

8. Më 14 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi formularin e plotësuar në Gjykatë.

9. Më 19 prill 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 23 mars 2016, përmes Vendimit nr. 02/81, ndër të tjera, Qeveria e Kosovës kishte miratuar edhe Koncept-dokumentin për rregullimin e fushës së pensioneve. Si shkak i këtij vendimi, parashtruesit të kërkesës, sipas pretendimeve të tij, i është ndërprerë pensioni i pleqërisë.

11. Nga dokumentet e dorëzuara në Gjykatë, rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë provë që tregon se ai ka iniciuar ndonjë procedurë

administrative apo gjyqësore për të realizuar të drejtën e tij, të cilin ai pretendon se i është shkelur si rezultat i vendimit të kontestuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është privuar nga e drejta e përfitimit të pensionit si rezultat i vendimit të lartpërmendur.

13. Parashtruesi i kërkesës thekson se nuk ka pranuar asnjë vendim nga autoriteti publik, përmes të cilit i është ndërprerë pensioni i pleqërisë. Mirëpo, ai thekson se vendimi i miratuar nga Qeveria e Kosovës përcakton ndërprerjen e pensionit, nëse individi është edhe përfitues i pensionit për familjet e dëshmorëve.

14. Parashtruesi i kërkesës deklaron se *"së bashku me familjen gëzojmë një pension për të birin tim dëshmor... ndihmën prej 165 euro, familja e gëzon si kompensim për birin tonë dëshmor e që është në emrin tim pasi unë jam baba"*.

15. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata *"që të shfuqizojë këtë vendim të pakuptimtë dhe jo të ligjshëm të Qeverisë së Kosovës"*.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> (...)
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

18. Gjykata po ashtu i i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, që parasheh:

> Neni 47
> [Kërkesa individuale]
>
> (...)
>
> *"2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

19. Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (b) [Kriteret e pranueshmërisë], të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 36
[Kriteret e pranueshmërisë]

"1. Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:

(...)

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar."

20. Paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës, paragrafi 2 i nenit 47 të Ligjit dhe pika (1) në lidhje me pikën (b) të rregullit 36 të Rregullores së punës, ndër të tjera, qartë përcaktojnë detyrimin e "*shterjes së mjeteve juridike të përcaktuara me ligj*", me kusht që një kërkesë të deklarohet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

21. Për më tepër, kriteret plotësuese sipas të cilave kërkesat e përcaktuara më lart, mund të konsiderohen të plotësuara, janë përcaktuar mirë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

22. Arsyetimi i kërkesës për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit është t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 të Kushtetutës dhe në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese. (Shih: Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) *Selmouni kundër Francës*, kërkesa nr. 25803/94, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, § 74 dhe, ndër të tjera, shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, nr. KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2016, § 61; rasti nr. KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafi 35, rasti nr. KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST ShPK.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, § 16; dhe rasti nr. KI94/14, parashtrues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, § 24).

23. Gjykata vazhdimisht ka respektuar parimin e subsidiaritetit, duke konsideruar se të gjithë parashtruesit duhet që të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurën e rregullt, me qëllim që të parandalojnë shkeljen e Kushtetutës ose, nëse ka, të korrigjojnë shkeljen e tillë të një të drejte themelore. Gjykata ka pohuar më tej se parashtruesit janë përgjegjës kur rastet e tyre përkatëse shpallen të papranueshme nga Gjykata, nëse nuk kanë shfrytëzuar procedurën

e rregullt ose nuk kanë raportuar shkelje të Kushtetutës në procedurat e rregullta. (Shih, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, rasti nr. 139/12, parashtrues *Besnik Asllani*, Vendim për kërkesën për masë të përkohshme dhe Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2013, § 45; KI07/09, parashtrues *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, §§ 18-19; rasti nr. KI89/15, parashtrues *Fatmir Koçi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 marsit 2016, § 35; KI24/16, parashtrues *Avdi Haziri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 nëntorit 2016, § 39; dhe rasti nr. KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, §§ 35-37).

24. Gjykata rithekson se kjo qasje kërkon që para se të drejtohen në Gjykatë, parashtruesit e kërkesës duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale, në procedura administrative ose gjyqësore, në procedurat e rregullta, për të parandaluar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë ose, nëse ka, për të korrigjuar një shkelje të tillë të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. (Shih, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, rasti nr. KI62/16, parashtrues *Bekë Lajçi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2017, §§ 59-60, dhe gjithashtu shih rastin nr. KI07/09, parashtrues: *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, §§ 18-19; rasti nr. KI109/15, parashtrues: *Milazim Nrecaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2016, §§ 27-28; KI148/15, parashtrues: *Xhafer Selmani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 prillit 2016, §§ 27-28).

25. Megjithatë, pavarësisht nga parimet e lartpërmendura, rregulli i shterimit, në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, zbatohet me një "*shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar*", duke pasur parasysh kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në parim, detyrimi për të shteruar mjetet juridike është i kufizuar në përdorimin e atyre mjeteve juridike, ekzistenca e të cilave është mjaft e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë; të cilat janë në dispozicion, të arritshme dhe efektive; dhe të cilat janë në gjendje të korrigjojnë drejtpërdrejt shkeljet e supozuara të KEDNJ-së. (Shih, ndër të tjera, *Selmouni kundër Francës*, §§ 71-81, *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, Seksioni B. Shterimi i mjeteve juridike të brendshme, §§ 55-77, *Demopolous dhe të tjerët kundër Turqisë*, Seksionet: A. Parashtresat para Gjykatës për shterimin e mjeteve të brendshme juridike dhe B. Shterjen e mjeteve juridike vendore, respektivisht, §§ 50-129; *Ocalan kundër Turqisë*, §§ 63-72; dhe *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, §§ 155-162). Përveç kësaj, një parashtrues nuk mund të konsiderohet se nuk i ka shteruar mjetet juridike nëse ai mund të tregojë, duke ofruar praktikën gjyqësore përkatëse ose ndonjë dëshmi tjetër të përshtatshme, se një mjet juridik në dispozicion të cilin ai nuk e ka shfrytëzuar, do të dështonte. (Rasti i *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, § 156 dhe referencat e përmendura aty, dhe *Selmouni kundër Francës*, §§ 74-77).

26. Përcaktimi nëse çdo rast specifik i plotëson kriteret në bazë të të cilave do të konsiderohej se plotësimi dhe heqja dorë nga kërkesa për shterjen e mjeteve juridike, duhet të bëhet në bazë të shpërndarjes së barrës së të provuarit, proces i përcaktuar qartë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. (*Selmouni*

kundër Francës, § 76 dhe referencat e përmendura aty, dhe *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 68 dhe referencat e përmendura aty).

27. Megjithatë, në të gjitha rastet dhe në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesi duhet të dëshmojë se "*ai ka bërë gjithçka që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga ai që të shterojë mjetet juridike*". (Shih *D. H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, § 116 dhe referencat e përmendura aty). Në fakt, edhe më tutje, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i referohet "*dyshimeve të thjeshta*" si arsye e pamjaftueshme për ta liruar një parashtrues nga shterimi i kërkesës për mjetet juridike. (Shih, ndër të tjera, *Epözdemir kundër Turqisë*, paragrafi i parë i fq. 6 dhe referencat e përmendura aty; *Milošević kundër Holandës*, paragrafët e fundit të fq. 6 dhe *MPP Golub kundër Ukrainës*, paragrafi i fundit i Seksionit C mbi Vlerësimin e Gjykatës). Përkundrazi, është në interes të parashtruesit të kërkesës që t'i drejtohet gjykatës kompetente për t'i dhënë asaj mundësinë që të ushtrojë të drejtat ekzistuese përmes fuqisë së saj të interpretimit. (Shih, ndër të tjera, *Ciupercescu kundër Rumanisë*, § 169).

28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi se ka kërkuar nga autoritetet publike që t'i dorëzohet një vendim për ndërprerjen e pensionit të tij. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi se i ka shfrytëzuar mjetet juridike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, përmes të cilave do të mund të kërkonte realizimin e të drejtës së tij në procedurë administrative dhe gjyqësore.

29. Për më tepër, Gjykata vëren se, në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë argument dhe dëshmi se ka shfrytëzuar ndonjë mjet juridik ose nëse mjetet juridike në dispozicion të tij janë të papërshtatshme dhe jo efektive, përmes të cilave ai do të mund të argumentonte se rregulli i shterimit të mjeteve juridike duhet të konsiderohet i plotësuar dhe hequr dorë në atë rast specifik. (Shih, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese: Rasti nr. KI116/14, parashtrues *Fadil Selmanaj,* Aktvendim për papranueshmëri, i 26 janarit 2015 §§ 45-46 dhe referencat e cituara në atë vendim).

30. Prandaj, për arsyet e përmendura më lart, Gjykata konstaton se kërkesa nuk i plotëson kriteret për pranueshmëri pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka shteruar mjetet juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës, dhe si e tillë, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme. (Shih, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2016, § 62, dhe rasti nr. KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, § 38).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 19 prill 2018, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani

Arta Rama-Hajrizi